



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1141/5 prot.

Datë 05.07.2022

V E N D I M

Nr. 631/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.07.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-26273-04-25-2022, me objekt: “*Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë*”, me fond limit 250,814,497.3 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

Ankimues: “Sireta 2F” SHPK.
Lagja "Babrru - Fushe" Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Lezhë
L. Skenderbeg, Sheshi “Gjergj Kastrioti”, 4501, Lezhe

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Ulza ” SHPK
Njësia bashkiake nr. 5, rruga Zef Jubani, ndërtesa 15, hyrja 19, ap 1, kodi postar 1019, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 26.04.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-26273-04-25-2022, me objekt: “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”, me fond limit 250,814,497.3 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.

II.2. Në datën 19.05.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si vijon:

1. “Sireta 2F” SHPK	222.222.222 lekë	skualifikuar
2. “Ulza” SHPK	244.691.098 lekë	kualifikuar
3. “Agri Construction” SHPK	247.955.560 lekë,	skualifikuar
4. “Hastoçi” SHPK	248.113.486 lekë	skualifikuar
5. “Udha” SHPK	248.113.486 lekë	skualifikuar

Operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK rezulton i skualifikuar me argumentet e mëposhtme
Arsyet e skualifikimit:

- IV. Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K me Nuis K51501008J,

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se: Se pari, nuk ka plotesuar Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit sipas formatit te miratuar ne DST.

I. KVO konsaton se Operatori Ekonomik nuk i eshte permbajtur formatit te miratuar ne DST-ne e procedures se prokurimit me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane ne territorin e Bashkise Lezhe”, ne plotesimin e Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit, ne seksionin “B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, ne te cilen percaktohet formati i deklarates, konkretisht si me poshte vijon: “Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,”.

II. KVO verën se ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit OE “SIRETA 2F” SH.P.K, ka shmangur qellimisht frazen “Z. _____ me profesion” dhe ka deklaruar se: “5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit. Se dyti, nuk permbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte: - Ing. Ndertimi 1 (nje) Diplome Universitare - Teknik ndertimi 3 (tre) Diplome shkolles mesme - Teknik mekanik 1 (nje) Diplome shkolles mesme - Karpertier 1 (nje) Deshmi Profesionale - Shofer 5 (pese) Leje Drejtimi.

- Manovrator 5 (pese) Certifikate e Aftesise Profesionale(CAP) Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperme: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperme te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2022 - Mars 2022. V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik. Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe

fillimit te afateve te ankimimit”. I. KVO thekson se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit e mbeshtetes qe disponon sipas përcaktimeve te mesiperme.

II. Nga verifikimi ne SPE, verehet se ne permbushje te kriterit 2.3.5, ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit OE “SIRETA 2F”, ka deklaruar se: “4. E.T, me profesion Inxhinier Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Inxhiere ndërtimi 5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh , A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit; 6. Teknik Mekanik: K.D, me profesion inxhinier Mekanike, Xh. H dhe I. M me profesion mekanik të punësuar pranë shoqërisë sonë; 7. Karpentier: Z.P dhe S. H me profesion karpentier të punësuar pranë shoqërisë sonë; 8. Shofer: D.D, E. D, A.M, I.L, M. Ç, J.H; Z.S; 9. Manovrator: T.L, E.L, M. N , B.M , A.I dhe A.M”

III. Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, me qellim vleresimin sa me objektiv te procedures, duke qene se eshte i paqarte profesioni per disa nga punonjesit e stafit mbeshtetes te paraqitur ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, me ane te shkrese se dates 16.05.2022 ne SPE, i kerkoi Operatorit Ekonomik te paraqese ne Sistemin e Elektronik te Prokurimeve brenda ores 14:00, te dates 17.05.2022, numrin e amzes dhe daten e leshimit te Diplomes se Shkolles Mesme, si dhe emrin e Shkolles se Mesme qe ka leshuar dokumentin per punonjesit e meposhtem: -Teknik ndertimi 1.Sh.Gj, 2.S.L, 3.K.K, 4.A.Xh, 5.A.P, -Si dhe Teknik mekanik 1.K.D, 2.Xh.H 3.I.M IV. Operatori Ekonomik me shkresen e dates 17.05.2022, ne SPE me lende “Dhenie informacioni”, paraqiti argumentet e tij ku rezulton se disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi (Sh.Gj), nga 3 (tre) te kerkuar ne DST, si dhe 1 nje teknik mekanik (Xh.H). Ndersa pjesa tjeter e stafit, te deklaruar ne Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, bazuar ne informacionin e paraqitur nga OE “SIRETA 2F”, nuk rezulton me profesion Teknik Ndertimi apo teknik mekanik me Diplome te Shkolles se Mesme siç eshte deklaruar ne kete formular, por si me poshte vijon: S.L - Kurs trajnimi per Teknik ndertimi (certificate trajnimi AQSCERT), Deshmi kualifikimi sigurimi Teknik – Trup certifikues TCPE K.K - Kurs Qendror Te pergatitjes dhe Kualifikimit te Kuadrove Bujqesore ne Tirane Teknik. A.Xh - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. A.P - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. Diplome Master i Shkencave Profili Gjeoteknik. K.D - Diplome Universiteti i Tiranës Fakulteti te Inxhinierise Mekanike dhe Elektrike, Titulli Inxhinier Mekanike Per Teknologji Makina Metal Prerese. I.M - Sherbimi Kombetar i Punesimit Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres Certificate Kualifikimi, (Kursi Mekanik). Sa me siper duke qene se OE disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi ne perputhje me kriterin 2.3.5 te DST-se nga 3 (tre) teknik ndertimi te kerkuar ne DST, ky kriter konsiderohet i papermbushur. Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.6 ku parashikohet se “Operatorët Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten: 2.3.6/a -1 (nje) Inxhinier te pajisur me certifikatë

“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022. 2.3.6/b -1 (nje) Punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022. 2.3.6/c -1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e. Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore" dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore”. Per te permbushur kete kriter duhet te paraqitet kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022. Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomike te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”. KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik ose mbeshtetes, te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme. Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, disponimin e 1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore te punesuar ne stafin teknik ose mbeshtetes per periudhen Janar 2022-Mars 2022, pasi ka deklaruar se disponon marreveshje bashkepunimi me z. F.H dhe Zj. K.D, duke mos permbushur kete kriter.

Se katerti, nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te dorezuar ne SPE, si dhe informacionin e paraqitur me daten 17.05.2022, pas kerkeses per sqarim nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, rezulton se Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K, ka paraqitur deklarate të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar dhe nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky OE ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit disponimin e 5 (pese) teknike ndertimi me diplome te shkolles se mesme, por nuk mund te dorezoje dokumentacion provues per kete deklarate. Operatori Ekonomik, bazuar ne informacionin e paraqitur ne SPE me date 17.05.2022, ka provuar me dokumentacion vetem disponimin e 1 (nje) tekniku ndertimi sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga 5 te deklaruar nga ana e tij. Per me teper, ne dokumentet e tenderit per kete procedure prokurimi, ne Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, kapitulli F, VLERËSIMI I OFERTAVE, pika 19/4 Kualifikimi i Operatoreve Ekonomik, parashikohet se: Operatori Ekonomik është

përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP). Po ashtu edhe në nenin 78, pika 1, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi”. Nisur sa me lart, si dhe bazuar në pikën 3/ë) të nenit 76 të ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme: ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mundësinë e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit”, si dhe në bazë të pikës 5, të nenit 76, të ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji”, KVO vendosi skualifikimin e Operatorit Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K për deklaram të rreme. Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbeshetur në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me

përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje ofertën e OE “SIRETA 2F” SH.P.K, për mospermbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese. Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “SIRETA 2F” SH.P.K me Nuis K51501008J, skualifikohet. V. Operatori Ekonomik “UDHA” SH.P.K me Nuis K77524909Q, nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE: Se pari, nuk plotëson kriterin 2.3.1, ku parashikohet se “Operatorët Ekonomike duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”. Theksojme se për të përmbushur piken 2.3.1, në lidhje me dëshmitë për përvojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet të paraqesin dokumentacion për realizimin e punëve të ngjashme me vlerë jo më të vogël se 50 % për një objekt të vetëm ose punë të ngjashme ku vlera totale e punëve është jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Nga verifikimi në SPE, rezulton se vlera e punëve të ngjashme të paraqitur nga ky OE është prej 46,112,493 leke pa TVSh dhe si rrjedhojë këto punë të ngjashme nuk arrijnë vlerën e 50% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Se dyti, nuk plotëson piken 2.3.2 pasi nuk provon disponimin e kategorive të nevojshme të licencës profesionale për zbatimin e kontratës. KVO verën se për të përmbushur këto kriter operatorët pjesëmarrës në këtë procedurë duhet të disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim e cila të përfshijë kategoritë e kërkuara në DST. Nga verifikimi në SPE rezulton se ky operator nuk disponon kategoritë e mëposhtme: PUNIME TË PERGJITHSHME NDËRTIMI N.P – 12 E Punime të inxhinierisë së mjedisit. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI N.S – 18 D Punime topogjeodezike. Se treti, nuk plotëson kriterin 2.3.3 ku parashikohet se “Operatorët Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 60 (gjashtedhjetë) personave të siguruar për periudhën Janar 2022 - Mars 2022. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë: a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin nga muajt e kërkuar; b) Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislati në fuqi. Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit”. KVO verën se bazuar në piken 1 të nenit 26, të VKM-se nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se, të dhënat e stafit e mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të mesipërme. Nga verifikimi në SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, disponimin

e numerit te punonjesve te punesuar prane OE, duke mos permbushur kete kriter. Se katerti, nuk ploteson kriterin 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6 pasi nuk ka vetedeklaruar ne formularin permbledhës të vetedeklarimit disponimin e Ing Mjedisi, teknik ndertimi, teknik mekanik, si dhe punonjesit e certifikuar. KVO verën se bazuar ne piken 1 te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për te permbushur kete kriter operatorët ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik, mbeshtetes dhe te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te DST-se. Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, disponimin e Ing Mjedisi, teknik ndertimi, teknik mekanik, si dhe punonjesit e certifikuar sipas pikes 2.3.6, duke mos permbushur kete kriter. Se pesti, nuk ploteson kriteret 2.3.8, 2.3.9, 2.3.10 te DST-se pasi nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe provon permbushjen e ketyre kriterëve. Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe ne në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi te refuzoje oferten e OE “UDHA” SH.P.K me Nuis K77524909Q, per mospermbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese. Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “UDHA” SH.P.K me Nuis K77524909Q, skualifikohet.

II.3. Në datën 24.05.2022 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit ku rezulton se ankimuesi bëhet me dije për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

“Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se:

***Se pari**, nuk ka plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas formatit të miratuar në DST.*

- I. *KVO konsaton se Operatori Ekonomik nuk i është përmbajtur formatit të miratuar në DST-ne e procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhe”, në plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në seksionin “**B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”**, në të cilën përcaktohet formati i deklaratës, konkretisht si më poshtë vijon: “Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, ”.*
- II. *KVO verën se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit OE “SIRETA 2F” SH.P.K, ka shmangur qëllimisht frazën “Z. _____ me profesion” dhe ka deklaruar se:*
“5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit.

***Se dyti**, nuk përmbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: “Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:*

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	3 (tre)	Diplome shkolles mesme
- Teknik mekanik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier	1 (nje)	Deshmi Profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi
- Manovrator	5 (pese)	Certifikate e Aftesise Profesionale(CAP)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mesiperm: Kontratat individuale të punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mesipërme si dhe stafi i mesiperm të figurojë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmitë/certifikatat) që nuk është leshuar sipas legjislacionit përkatës të arsimit profesional do të konsiderohen jo të sakta dhe behen shkak për veprime të metejshme sipas parashikimeve përkatëse të ligjit të prokurimit publik.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit”.

- I. *KVO thekson se bazuar në piken 1, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si*

provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-se, të dhenat e stafit e mbështetës që disponon sipas përcaktimeve të mesipërme.

II. Nga verifikimi në SPE, vërehet se në përmbushje të kriterit 2.3.5, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit OE "SIRETA 2F", ka deklaruar se:

1. **E.T**, me profesion Inxhinier Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Inxhiere ndërtimi
2. **Teknik ndertimi**: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit;
3. **Teknik Mekanik**: K.D, me profesion inxhinier Mekanike, Xh.H dhe I.M me profesion mekanik të punësuar pranë shoqërisë sonë;
4. **Karpiertier**: Z.P dhe S.H me profesion karpiertier të punësuar pranë shoqërisë sonë;
5. **Shofer**: D.D, E.D, A.M, I.L, M.Ç, J.H; Z.S;
6. **Manovrator**: T.L, E.L, M.N, B.M, A.I dhe A.M"

III. Në vijim, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, me qëllim vlerësimit sa më objektiv të procedurës, duke qenë se është i paqartë profesioni për disa nga punonjësit e stafit mbështetës të paraqitur në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, me anë të shkresë se datës 16.05.2022 në SPE, i kërkoj Operatorit Ekonomik të paraqesë në Sistemin e Elektronik të Prokurimeve brenda orës 14:00, të datës 17.05.2022, numrin e amzës dhe datën e leshimit të Diplomes së Shkolles Mesme, si dhe emrin e Shkolles së Mesme që ka leshuar dokumentin për punonjësit e mëposhtëm:

-Teknik ndertimi

- 1.Sh.Gj,
- 2.S.L,
- 3.K.K,
- 4.A.Xh,
- 5.A.P,

-Si dhe Teknik mekanik

- 1.K.D,
- 2.Xh.H
- 3.I.M

IV. Operatori Ekonomik me shkresën e datës 17.05.2022, në SPE me lende "Dhënie informacioni", paraqiti argumentet e tij ku rezulton se disponon vetëm 1 (një) teknik ndertimi (Sh.Gj), nga 3 (tre) të kërkuar në DST, si dhe 1 një teknik mekanik (XH.H). Ndërsa pjesa tjetër e stafit, të deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, bazuar në informacionin e paraqitur nga OE "SIRETA 2F", nuk rezulton me profesion Teknik Ndertimi apo teknik mekanik me **Diplome të Shkolles së Mesme** siç është deklaruar në këtë formular, por si më poshtë vijon:

S.L - Kurs trajnimi për Teknik ndertimi (certifikate trajnimi AQSCERT), Dëshmi kualifikimi sigurimi Teknik – Trup certifikues TCPE

K.K - Kurs Qendror të përgatitjes dhe Kualifikimit të Kuadrove Bujqesore në Tiranë Teknik.

A.Xh - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndertimit – Diplome Bachelor në Inxhinieri Ndertimi.

A.P - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierisë së Ndertimit – Diplome Bachelor në Inxhinieri Ndertimi. Diplome Master i Shkencave Profili Gjeoteknik.

K.D - Diplome Universiteti i Tiranës Fakulteti të Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike, Titulli Inxhinierë Mekanike Për Teknologji Makina Metal Prerese.

I.M - Sherbimi Kombëtar i Punesimit Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres Certifikate Kualifikimi, (Kursi Mekanik).

Sa me sipër duke qenë se OE disponon vetëm 1 (një) teknik ndertimi në përputhje me kriterin 2.3.5 të DST-së nga 3 (tre) teknik ndertimi të kerkuar në DST, ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Se treti, nuk plotëson kriterin 2.3.6 ku parashikohet se “Operatorët Ekonomikë duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të pakten:

2.3.6/a -1 (një) Inxhinier të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Për të përmbushur këto kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplome dhe certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

2.3.6/b -1 (një) Punonjës i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Për të përmbushur këto kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

2.3.6/c -1 (një) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore, i certifikuar sipas VKM nr 125 datë 23.02.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 datë 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore”.

Për të përmbushur këto kriter duhet të paraqitet kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

Shënim: Kjo kerkese përmbushet nepermjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së dhe dokumentacioni i kerkuar duhet të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe fillimit të afatëve të ankimimit”.

KVO verën se bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe për të përmbushur këto kriter operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vetedeklarojnë në formularin përmbledhës të vetedeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së, të dhenat e stafit teknik ose mbështetës, të certifikuar që disponon sipas përcaktimeve të mesipërme.

Nga verifikimi në SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, disponimin e 1 (një) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore të

punesuar ne stafin teknik ose mbeshtetes per periudhen Janar 2022-Mars 2022, pasi ka deklaruar se disponon **marreveshje bashkepunimi** me z. F.H dhe Zj. K.D, duke mos permbushur kete kriter.

Se katerti, nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te dorezuar ne SPE, si dhe informacionin e paraqitur me daten 17.05.2022, pas kerkeses per sqarim nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, rezulton se Operatori Ekonomik "SIRETA 2F" SH.P.K, ka paraqitur deklarate te rreme ne dhënien e informacionit të kërkuar dhe nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky OE ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit disponimin e 5 (pese) teknike ndertimi me diplome te shkolles se mesme, por nuk mund te dorezoje dokumentacion provues per kete deklarate.

Operatori Ekonomik, bazuar ne informacionin e paraqitur ne SPE me date 17.05.2022, ka provuar me dokumentacion vetem disponimin e 1 (nje) teknik ndertimi sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga 5 te deklaruar nga ana e tij.

Per me teper, ne dokumentet e tenderit per kete procedure prokurimi, ne Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, kapitulli F, VLERËSIMI I OFERTAVE, pika 19/4 Kualifikimi i Operatoreve Ekonomik, parashikohet se: **Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).**

Po ashtu edhe ne nenin 78, pika 1, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" parashikohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për:

a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi".

Nisur sa me lart, si dhe bazuar ne piken 3/ë) te nenit 76 te ligjit nr. 162 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se: "Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit", si dhe ne baze te pikes 5, te nenit 76, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji", KVO vendosi skualifikimin e Operatorit Ekonomik "SIRETA 2F" SH.P.K per deklarim te rreme.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të

përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e OE “SIRETA 2F” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “SIRETA 2F” SH.P.K me Nuis K51501008J, skualifikohet.

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 30.05.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1141/2022 protokoli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2231 e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK. Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Sireta 2F” SHPK në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Se pari sqarojme se gjate pergatitjes se ofertes kemi pasur ne konsiderate parashikimet ligjore, parimet e prokurimit publik dhe zbatimin ne praktike ku dhe KPP ne vijimesi ka sqaruar se vendosja e kriterëve të vecanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatoreve ekonomike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi dhe Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për këtë arsye operatori jone ekonomik "Sireta 2F" ShPK ne

momentin e paraqitjes se ofertes ka analizuar te gjithe elementet perberes te dokumenteve te tenderit dhe ka paraqitur nje oferte ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.

Ne vijim marrim ne analize secilen nga arsyet e pretenduara nga ana e komisionit te vleresimit te ofertave per te argumentuar/sqaruar/provuar se arsyet e skualifikimit nuk qendrojne dhe se oferta e paraqitur nga ana e operatorit tone ekonomik "SIRETA 2F" shpk eshte ne perputhje plote me te gjitha kerkesat e specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit:

Se dyti, marrim ne analize arsyen e pare te skualifikimit. Komisioni i vleresimit te ofertave pretendon: Operatori ekonomik "SJRETA 2F" SHP.K me Nids K51501008J, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se: Se pari nuk ka plesuar Formularin Permbledhes te vetdeklarimit sipas formatit te miratuar ne DST.

I.KVO konsaton se Operatori Ekonomik nuk i eshte permbajtur formatit te miratuar ne DST-ne e procedures se prokurimit me objekt "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugeve rurale dhe urbane ne territorin e Bashkise Lezhe", ne plotesimin e Formularit Përmbledhës te Vetëdeklarimit, ne seksionin "**B: DEKLARATË "Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate"**", ne te cilen percaktohet formati i deklarates, konkretisht si me poshte vijon: "Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, ". II. KVO verën se ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit OE "SIRETA 2F" SH.P.K, ka shmangur qellimisht frazen "Z. _____ me profesion" dhe ka deklaruar se:

"5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit.

Referuar arsyes se pare te skualifikimit parashtrojme se kjo arsye nuk eshte ne perputhje me parashikimet ligjore te prokurimit publik, pasi fakti qe Operatori jone ekonomik nuk ka cituar fjale per fjale gjate pergatitjes se formularit permbledhes se vetedeklarimit profesionin e punonjesve te deklaruar nuk e ben kete formular jo ne perputhje me parashikimet e dokumenteve te tenderit apo ne kundërshtim me formatin e formularit te miratuar. Qellimi i ketij formulari eshte qe Autoriteti kontraktor te krijojë bindjen rreth disponimit te personelit kryesor sipas profileve te kerkuara ne dokumentet e tenderit. Operatori jone ekonomik e ka bere te qarte ne formularin permbledhes te vetedeklarimit pozicion e secilit personel te deklaruar per kete procedure. Referuar formularit te dorezuar ne SPE rezulton:

Punonjes Po [X] Jo []

Nese, po, numri i punonjesve eshte mesatarisht punonjes ne muaj. Shoqeria disponon me shume se 60 punonjes sipas përcaktimeve te D.S. T- (mesatarisht gjate 3 muajve te fundit jane 90 punonjes). Gjithashtu, disponoj personelin kryesor te poshteshenuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) perkatese:

1. Z. B.Sh, me profesion inxhinier ndertimi, ne licence, i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin DREJTUES TEKNIK Inxhinier ndertimi.
2. Z. A.C, me profesion inxhinier mjedisi, ne licence, i punesuar prane shoqerise sone, ne rolin DREJTUES TEKNIK Inxhinier mjedisi.

3. D.F, me profesion i xh.Gjeodet, e punesuar prane shoqerise sone, ne rolin Drejtuese Teknike inxhinier gjeodet.
4. E.T, me profesion lnxhinier Ndertimi, e punesuar prane shoqerise sone, ne rolin inxhinier ndertimi.
5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, te punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e teknikeve te ndertimit;
6. Teknik Mekanik: K.D, me profesion inxhinier Mekanike, Xh.H dhe I.M me profesion mekanik te punesuar prane shoqerise sone;
7. Karpentier: Z.P dhe S.H me profesion karpentier te punesuar prane shoqerise sone;
8. Shofer: D.D, E.D, A.M, I.L, M.C, J.H; Z.S
9. Manovrator: T.L, E.L, M.N, B.M, A.I dhe A.M.
10. Pergjegjes per sigurine dhe mbrajtjen e shendetit ne pune: B.Sh, me profesion inxhinier Ndertimi, Drejtues Teknik i punimeve, ne licence.
11. Ekspert per Ndhmen e Pare dhe Nderhyrjen ndaj Emergjencave: E.M (Ruci) dhe M.M;
12. Auditues/Inspektues i sigurise rrugore: F.H, me kontrate bashkepunimi noteriale nr. Rep 5254 dhe nr.kal 2572, dhe K.D.

Plotesimi i formularit permbledhes nga OE e ka bere te qarte se cilin deklarimin per secilin personel te kerkuar nga AK. Autoriteti Kontraktor nuk mund te pretendoje se nuk kuptohet personeli i deklaruar nga OE, pasi formulari eshte lehtesisht i kuptueshem. Kemi dale nga formati vetem ne dy- tre raste, te cilat nuk jane bere me qellim, por per lehtesi dhe qartesi gjate hartimit te formularit. Dhe ne keto raste kuptohet lehtesisht pozicioni per te cilin jane deklaruar. Ne lidhje me pretendimin e KVO se ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit OE "SIRETA 2F" ShPK ka shmangur qellimisht frazen "Z. me profesion" dhe ka deklaruar se "5 Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, te punesuar prane shoqerise sone ne rolin e teknikeve te ndertimit, sqarojme se mospercaktimi i profesionit nuk ka pasur ndonje qellim, dhe se fakti qe formulari eshte plotesuar si vijon: 5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K. K, A.Xh, A.P, te punesuar prane shoqerise sone, ne rolin e teknikeve te ndertimit, nuk perben arsye per te konsideruar formularin jo te sakte. Deklarimi ne formular si me larte eshte i mjaftueshme per te kuptuar se kush eshte personeli i cili eshte deklaruar per te plotesuar kriterin per 3 teknik ndertimi te percaktuar/kerkuar ne dokumentet e tenderit, pasi kemi percaktuar teknik ndertimi, emrat perkates si dhe faktin qe ky personel eshte i punesuar prane shoqerise sone. Deklarimi ne kete forme eshte i mjaftueshem per tu kuptuar. Per me teper qe Autoritetit Kontraktor gjate vleresimit te ofertave legjislatori i ka garantuar momentin procedural e te drejten per te kerkuar informacion per cdo paqartesi duke kerkuar sqarime nga ofertuesit.

Se treti, marrim ne analize arsyen e dyte te skualifikimit KVO pretendon se: " **Se dyti**, nuk permbush kriterin 2.3.5, ku parashikohet se: "Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Ing. Ndertimi	1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi	3 (tre)	Diplome shkolles mesme
- Teknik mekanik	1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpentier	1 (nje)	Deshmi Profesionale
- Shofer	5 (pese)	Leje Drejtimi
- Manovrator	5 (pese)	Certifikate e Aftesise Profesionale(CAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmite profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen Janar 2022 - Mars 2022.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik. Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

I.KVO thekson se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit e mbeshtetes qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.

II.Nga verifikimi ne SPE, verehet se ne permbushje te kriterit 2.3.5, ne formularin përmbledhës te vetëdeklarimit OE “SIRETA 2F”, ka deklaruar se:

“4. E.T, me profesion Inxhinier Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Inxhiere ndërtimi

5. **Teknik ndertimi:** Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit;

6. **Teknik Mekanik:** K.D, me profesion inxhiniere Mekanike, Xh.H dhe I.M me profesion mekanik të punësuar pranë shoqërisë sonë;

7. **Karpentier:** Z.P dhe S.H me profesion karpentier të punësuar pranë shoqërisë sonë;

8. **Shofer:** D.D, E.D, A.M, I.L, M.Ç, J.H; Z.S;

9. **Manovrator:** T.L, E.L, M.N, B.M, A.I dhe A.M”

III. Ne vijim, Komisioni i Vleresimit te Ofertave, me qellim vleresimin sa me objektiv te procedures, duke qene se eshte i paqarte profesioni per disa nga punonjesit e stafit mbeshtetes te paraqitur ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, me ane te shkrese se dates 16.05.2022 ne SPE, i kerkoj Operatorit Ekonomik te paraqese ne Sistemin e Elektronik te Prokurimeve brenda ores 14:00, te dates 17.05.2022, numrin e amzes dhe daten e leshimit te Diplomes se Shkolles Mesme, si dhe emrin e Shkolles se Mesme qe ka leshuar dokumentin per punonjesit e meposhtem:

-Teknik ndertimi

1.Sh.Gj,

2.S.L,

3.K.K,

4.A.Xh,

5.A.P,

-Si dhe Teknik mekanik

1.K.D,

2.Xh.H

3.I.M

IV.Operatori Ekonomik me shkresen e dates 17.05.2022, ne SPE me lende “Dhënie informacioni”, paraqiti argumentet e tij ku rezulton se disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi (Sh.Gj), nga 3 (tre) te kerkuar ne DST, si dhe 1 nje teknik mekanik (Xh.H).

Ndersa pjesa tjeter e stafit, te deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit, bazuar ne informacionin e paraqitur nga OE “SIRETA 2F”, nuk rezulton me profesion Teknik Ndertimi apo teknik mekanik me **Diplome te Shkolles se Mesme** siç eshte deklaruar ne kete formular, por si me poshte vijon:

S.L - Kurs trajnimi per Teknik ndertimi (certifikate trajnimi AQSCERT), Deshmi kualifikimi sigurimi Teknik – Trup certifikues TCPE

K.K - Kurs Qendror Te pergatitjes dhe Kualifikimit te Kuadrove Bujqesore ne Tirane Teknik.

A.Xh - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi.

A.P - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. Diplome Master i Shkencave Profili Gjeoteknik.

K.D - Diplome Universiteti i Tiranës Fakulteti te Inxhinierise Mekanike dhe Elektrike, Titulli Inxhinierë Mekanike Per Teknologji Makina Metal Prerese.

I.M - Sherbimi Kombetar i Punesimit Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres Certifikate Kualifikimi, (Kursi Mekanik).

Sa me siper duke qene se OE disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi ne perputhje me kriterin 2.3.5 te DST-se nga 3 (tre) teknik ndertimi te kerkuar ne DST, ky kriter konsiderohet i papermbushur.

Komisioni i vleresimit te ofertave ka gabuar ne percaktimin si te papermbushur te ketij kriteri nga ana jone, pasi formulari i vetedeklarimit eshte plotesuar sipas kerkesave te AK, dokumenteve te tenderit, madje duke tejkualuar percaktimet/kerkesat e dokumenteve te tenderit. Sqarojme se ne dokumentet e tenderit kerkohet:

2.3.5 Krahas stafit teknik Operatoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Ing. Ndertimi	(Profili Transport)	1 (nje)	Diplome Universitare
- Ing. Ndertimi		1 (nje)	Diplome Universitare
- Teknik ndertimi		3 (tre)	Diplome shkolles mesme
- Teknik mekanik		1 (nje)	Diplome shkolles mesme
- Karpertier		1 (nje)	Deshmi Profesionale
- Shofer		10 (dhjete)	Leje Drejtimi
- Manovrator		10 (dhjete)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

Operatori ekonomik duhet te paraqese per stafin e mesiperme: Kontratate individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si

dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen **Janar 2022 - Mars 2022**.

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

Ne formularin permbledhes te vetedeklarimit operatori yne ekonomik, per te permbushur piken 2.3.5 te dokumenteve te tenderit, ka deklaruar personelin duke plotesuar kerkesen e AK si me poshte: [...]

Per sa me lart, sic vertetohet nga formular permbledhes i vetedeklarimit, si edhe nga tabela me larte, operatori yne ka plotesuar te gjitha kerkesat e pikes 2.3.5 te dokumenteve te tenderit, madje duke i tejkaluar kerkesat e percaktuara. Kjo gje eshte bere per te forcuar bindjen e AK ne lidhje me kapacitetet tona per realizimin me sukses te kontrates. Komisioni i vleresimit te ofertave pretendon se ka qene i paqarte ne lidhje me profesionin per disa nga punonjesit e stafit mbeshtetes te paraqitur dhe ka perdorur momentin procedural te garantuar nga ligji per te kerkuar sqarim. Ne pergjigje te kerkeses se KVO-se ne kemi paraqitur informacionin e kerkuar. Pretendimi nga ana e Komisionit se "rezulton se disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi (Sh.Gj) nga 3 (tre) te kerkuar ne DST, si dhe 1 teknik mekanik (Xh.H) ", nuk qendron. a. Sqarojme se ne dokumentet e tenderit jane kerkuar 3 teknik ndertimi dhe nga ana e operatorit tone jane deklaruar 5 punonjes:

Po marrim ne analize punonjesit e deklaruar per te vertetur qe plotesohet kriteri i vendosur nga AK:

1. A.Xh, i deklaruar per pozicionin e teknikut te ndertimit, sqarojme se eshte pajisur nga Universiteti Politeknik i Tiranës - Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit - Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. Nr. Amze P0582A060003 - Nr. Diplome B-2683 dt.05.04.2019;

2. A.P i deklaruar per pozicionin e teknikut te ndertimit, sqarojme se eshte pajisur nga Universiteti Politeknik i Tiranës - Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit - Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. Nr. Amze 1380 - Nr. Dip Jome - B - 303 dt.08.10.2010 Diplome Master i Shkencave Profili Gjeoteknik Nr. Anize POTNDB - 200167 Nr. Diplome- M- 351 dt.19.07.2012;

3. K.K, i deklaruar per pozicionin e teknikut te ndertimit, sqarojme se eshte pajisur me Diplome nr. 9, Nr. Anize 931 dt.29.06.1986 - Kurs Qendror Te pergatitjes dhe Kualifikimit te Kuadrove Bujqesore ne Tirane Teknik. Licence Nr. Z328 I II "Per Zbatim" - Ministria e Puneve Publike-Komisioni i Dhenies se Licencave Profesionale, si dhe certificate per kurs formimi dhe trajnimi per teknik ndertimi, leshuar nga shoqeria HEALTH SAFETY ENVIRONMENT MANAGEMENT SHPK me NUIS L62430006B.;

4. Sh.Gj i deklaruar per pozicionin e teknikut te ndertimit, sqarojme se eshte pajisur nga Ministria e Ndertimit, Republika Popullore Socialiste e Shqiperise-Shkolla e Ulet e Ndertimit Tirane i kualifikuar saldator-hekurthyes. Diplome e shkolles se mesme nr.147 Nr. 2110 amze date 21.11.1980, si dhe certificate per kurs formimi dhe trajnimi per teknik ndertimi leshuar

nga shoqeria HEALTH SAFETY ENVIRONMENT MANAGEMENT SHPK me NUIS L62430006B.

5. S.L i deklaruar per pozicionin e teknikut te ndertimit, sqarojme se ka ndjekur kurs trajnimi per Teknik ndertimi dhe eshte pajisur me certificate trajnimi nga AQSCERT AQS/T/S51042020 dt.20.06.2020. Deshmi kualifikimi sigurimi Teknik Nr.014545 - CN 003 dt.15 .10.2015 - Trup certifikues TCPE.

Fakti qe ne kemi paraqitur z. A.P dhe z. A.Xh si teknik ndertimi, te cilet kane perfunduar studimet e larta per inxhinieri ndertimi, nuk permben shkak qe KVO te mos e konsideroje te plotesuar kriterin. Inxhinieria e ndertimit e perfshin kualifikimin e teknikut te ndertimit. Paraqitja e nje kualifikimi me te larte se ai i kerkuar nuk e ben te paplotesuar apo te paplote plotesimin e nje kriter, por perkundrazi AK duhet ta vleresoje dhe ta konsideroje si nje garanci me shume per realizimin me sukses te kontrates.

z. K.K sic; e kemi sqaruar edhe me ane te shkreses date 17.05.2022 zoteron Deshmi nr. 9 Nr. Amze 931 dt.29.06.1986 - Kurs Qendror te pergatitjes dhe Kualifikimit te Kuadrove Bujqesore ne Tirane Teknik, si dhe zoteron Licencen Nr. Z3281/1 "Per Zbatim" - Ministria e Puneve Publike-Komisioni i Dhenies se Licencave Profesionale per kategorite e specifikuar te punimeve:

Per zbatim:

Kat. I- Punime dheu, sistemime, tarracime terrenesh etj,

Kat. 2/a-prodhim material inerte, rere, cakull etj,

Kat. 3/a ndertime civile, industrial, turistike etj,

Kat. 4/a- ndertim rruge kat V, IV,

Kat. 6/a ndertim vepra arti te vogla

Me ane te licenses se leshuar nga Ministria e Puneve Publike ka gene licensuar per zbatim dhe regjistruar ne regjistrin themeltar te zbatimit sipas rregullave te kohes ne vitin 2001 per kategorite specifike te punimeve te percaktuara ne licence. Sic shikohet edhe nga licensa z. Kaloshi eshte i licensuar per kategorite e punime ne rruge, per kategorite e punimeve te cilat kryhen nga teknik ndertimi. Licensat e leshuara ne kete periudhe jane pa afat.

Gjithashtu sqarojme se z. Kaloshi eshte i pajisur edhe me certificate per kurs formimi dhe trajnimi per teknik ndertimi leshuar nga shoqeria HEALTH SAFETY ENVIRONMENT MANAGEMENT SHPK. Nga sa paraqitem per z. Kaloshi kuptohet qarte se zoteron te gjitha kualifikimet e nevojshme per tu konsideruar teknik ndertimi dhe realizuar kete funksion.

z. Gjyzeli, eshte pajisur nga Ministria e Ndertimit-Shkolla e Ulet e Ndertimit Tirane me Diplome e shkolles se mesme nr.147 Nr. 2110 amze date 21.11.1980 i kualifikuar saldator-hekurthyes, si dhe certificate per kurs formimi dhe trajnimi per teknik ndertimi leshuar nga shoqeria HEALTH SAFETY ENVIRONMENT MANAGEMENT SHPK me NUIS L62430006B, pra zoteron kualifikimin e nevojshem per tu konsideruar teknik ndertimi dhe realizuar kete funksion. z. S.L ka ndjekur dhe eshte pajisur: Kurs trajnimi per Teknik ndertimi (certificate trajnimi AQSCERT) AQS/T/S51042020 dt.20.06.2020. Deshmi kualifikimi sigurimi Teknik Nr.014545 - CN 003 dt.15.10.2015 - Trup certifikues TCPE dhe zoteron te kualifikimin e nevojshme per tu konsideruar teknik ndertimi dhe realizuar kete funksion.

Per sa paraqitem dhe sqaruar me larte rezulton se plotesojme kerkesen e vendosur prej 3 teknikeve te ndertimit me arsimim minimal "Shkolla e mesme", duke tejkualuar kualifikimin e kerkuar, pasi kemi paraqitur staf te kualifikuar inxhinier ndertimi.

Nese AK edhe pas sqarimit te derguar nga ana jone do te kishte paqartesi ne lidhje me plotesimin e ketij kriteri mund te kishte kerkuar paraqitjen e dokumentacionit perkates, te drejte te cilen ia njej ligjislacioni i prokurimit publik, si dhe nga ana jone eshte shprehur gatishmeria per te vene ne dispozicion cfare do lloj informacioni, dokumentacioni ne sqarim e derguar ne date 17.05.2022 duke u shprehur "Jemi te hapur per cdo sqarim dhe informacion qe do te na kerkohet nga ana juaj".

Sqarojme edhe nje here se Operatori yne ekonomik ne plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur stafin me kualifikim me te larte se ai kerkuar duke pasur qellimin pozitiv per ti treguar Autoritetit Kontraktor se jo vetem qe plotesojme kriterin e kerkuar, por edhe e tejkalojme ate per treguar besueshmeri, seriozitet si dhe per ta garantuar rreth kapaciteteve tona gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

b. Sqarojme se ne dokumentet e tenderit eshte kerkuar 1 teknik mekanik dhe nga ana e operatorit tone jane deklaruar 3 punonjes:

Po marrim ne analize nga punonjesit e deklaruar per te vertetur qe plotesohet kriteri i vendosur nga AK:

1. Xh.H Seksioni i Arsimit dhe Kultures Rrethit Durres. Shkolla e Mesme Mekanike Bujqesore Nr. Amze 1316 - Nr.regj . i veçantë 975 dt.30.06.1974;

z. Hysenaj ka perfunduar shkollen e mesme mekanike dhe me deklarimin e tij plotesohet kerkesa e vendosur ne piken 2.3.5 te dokumenteve te tenderit.

2. K.D, Diplome Universiteti i Tiranes, Fakulteti te Inxhinierise Mekanike dhe Elektrike Nr. 1662 amze date 05.07.1991, Nr.779/1 - Titulli Inxhinier Mekanike Per Teknologji Makina Metal Prerese; Inxhinieria mekanike e perfshin kualifikimin e mekanikut. Paraqitja e nje kualifikimi me te larte se ai i kerkuar nuk e ben te paplotesuar apo te paplote plotesimin e nje kriter, por perkundrazi AK duhet ta vleresoje dhe ta konsideroje si nje garanci me shume per realizimin me sukses te kontrates.

3. I.M Sherbimi Kombetar i Punesimit Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Durres Certificate Kualifikimi nr. Amze 428 dat. 18.11.2019 (Kursi Mekanik).

Kerkesa per Teknik mekanik plotesohet me paraqitjen e z. Xh.H sipas kerkeseve te dokumenteve te tenderit i cili ka perfunduar shkollen e mesme mekanike dhe me deklarimin e tij plotesohet kerkesa e vendosur ne piken 2.3.5 te dokumenteve te tenderi. Paraqitja e dy punonjesve te tjere eshte bere per ti dhene garancia dhe siguri AK per realizimin me sukses te kontrates. Nisur edhe nga fakti qe AK nuk ka kerkuar drejtues teknik ing. Mekanik kemi paraqitur z. K.D ne kete pike. Sqarojme edhe nje here se Operatori yne ekonomik ne plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur stafin me kualifikim me te larte se ai kerkuar duke pasur qellimin pozitiv per ti treguar Autoritetit Kontraktor se jo vetem qe plotesojme kriterin e kerkuar por edhe e tejkalojme ate, per te treguar besueshmeri, seriozitet si dhe per ta garantuar rreth kapaciteteve tona gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Sa me siper duke qene se disponojme stafin e kerkuar ne perputhje dhe ne tejkallim me kriterin 2.3.5 te dokumenteve te tenderit, ky kriter konsiderohet i permbushur dhe arsyeja e paraqitur nga KVO nuk qendron pasi eshte e pabazuar, Operatori yne ploteson edhe kerkesen per teknik ndertimi edhe kerkesen per teknik mekanik.

Se katerti, marrim ne analize arsyen e trete te skualifikimit KVO pretendon se: **“Se treti, nuk ploteson kriterin 2.3.6 ku parashikohet se “Operatoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:**

2.3.6/a -1 (nje) Inxhinier te pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, diplome dhe certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

2.3.6/b -1 (nje) Punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave”, e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqese kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

2.3.6/c -1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore, i certifikuar sipas VKM nr 125 date 23.02.2011 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore” dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore”.

Per te permbushur kete kriter duhet te paraqitet kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listëpagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operatoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit”.

KVO veren se bazuar ne piken 1, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomik pjesmarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik ose mbeshtetes, te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme.

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, disponimin e 1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore te punesuar ne stafin teknik ose mbeshtetes per periudhen Janar 2022-Mars 2022, pasi ka deklaruar se disponon **marreveshje bashkepunimi** me z. F.H dhe Zj. K.D, duke mos permbushur kete kriter.”

Ne lidhje me kete arsye skulifikimi sqarojme se pretendimi i KVO nuk qendron, pasi per te permbushur kete kriter nga ana jone eshte deklaruar kontrata e bashkepunimit me z. F. H, me kontrate bashkepunimi noteriale nr. Rep 5254 dhe nr.kol 2572 date 11.05.2022 si dhe eshte deklaruar punonjesja jone inxhinierja znj. K.D. Znj. Duka sic eshte deklaruar edhe ne piken 6 te deklarates "B Deklarate “Per disponimin e punonjesve te nevojshme per realizimin e punimeve objekt-kontrate" 6. Teknik Mekanik: K.D, me profesion inxhinierie Mekanike, Xh.H dhe I.M me profesion mekanik te punesuar prane shoqerise sone; eshte me profesion inxhinierie mekanike. Ajo ka ndjekur kurs trajnimi per "Trajnim per Auditor i Brendshmem per menaxhimin e sigurise ne trafikun rrugor" dhe eshte pajisur me certifikate trajnimi nga AQSCERT, AQS/T/S93432022 dt.25.02.2022, pra zoteron kualifikim per inxhinierie

Auditues/[nspektues i Sigurise Rrugore dhe realizuar kete funksion. Ajo eshte e punesuar prane shoqerise sone prej vitesh, periudhe e cila perfshin edhe periudhen Janar 2022-Mars 2022. Nga ana e shoqerise sone eshte deklaruar/mare persiper e te realizohet kerkesa e AK per sigurine rrugore nga bashkepunimi i z. F.H (me te cilin eshte lidhur marreveshje bashkepunimi per ofrimin e sherbimit) si dhe znj. K.D e cila eshte e punesuar prane shoqerise sone. Nese AK ka pasur paqartesi ne lidhje me plotesimin e deklarates per kete pike ka pasur ne dispozicion momentin procedural per te kerkuar sqarime sic kerkoj sqarime ne lidhje me profesionin e disa prej personelit te deklaruar ne formular. Gjithashtu, sic eshte cituar edhe vete KVO ne arsyetimin e tyre, ne kete faze nga ana e OE plotesohet formulari permbledhes vetedeklarimit dhe i gjithë dokumentacioni i kerkuar, provues dorezohet ne fazen tjeter, konkretisht "perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit, bazuar ne piken I, te nenit 26, te VKM-se nr. 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: Bashke me dorezimin e kerkeseve per pjesemarrje ose te ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si prove paraprake, ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas percaktimit ne nenin 82, te LPP-se, dhe ne keto rregulla, dhe per te permbushur kete kriter operatoret ekonomike pjesemarres duhet te vetedeklarojne ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se, te dhenat e stafit teknik ose mbeshtetes, te certifikuar qe disponon sipas percaktimeve te mesiperme. Nga sa argumentuam me siper, arsyeja e skualifikimit e paraqitur nga KVO nuk qendron dhe eshte e pabazuar.

Se pesti, marrim ne analize arsyen e katert te skualifikimit KVO pretendon se: **“Se katerti,** nga verifikimi i Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit te dorezuar ne SPE, si dhe informacionin e paraqitur me daten 17.05.2022, pas kerkeses per sqarim nga ana e Komisionit te Vleresimit te Ofertave, rezulton se Operatori Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K, ka paraqitur deklarate të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar dhe nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ky OE ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit disponimin e 5 (pese) teknike ndertimi me diplome te shkolles se mesme, por nuk mund te dorezoje dokumentacion provues per kete deklarate.Operatori Ekonomik, bazuar ne informacionin e paraqitur ne SPE me date 17.05.2022, ka provuar me dokumentacion vetem disponimin e 1 (nje) tekniku ndertimi sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga 5 te deklaruar nga ana e tij.

Per me teper, ne dokumentet e tenderit per kete procedure prokurimi, ne Seksionin I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë, kapitulli F, VLERËSIMI I OFERTAVE, pika 19/4 Kualifikimi i Operatoreve Ekonomik, parashikohet se: **Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e Ofertës. Në rast të verifikimit të përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur, ose të Vetëdeklarimeve, kur përmbajtja e tyre nuk rezulton të jetë e vërtetë, Operatori Ekonomik është në kushtet e parashikuara në nenin 78, pika 1, gërma (a) të Ligji për Prokurimin Publik (LPP).**

Po ashtu edhe ne nenin 78, pika 1, e ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” parashikohet se: “Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për:

a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi”.

Nisur sa me lart, si dhe bazuar ne piken 3/ë) te nenit 76 te ligjit nr. 162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se: **“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:**

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit”, si dhe ne baze te pikes 5, te nenit 76, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji”,** KVO vendosi skualifikimin e Operatorit Ekonomik “SIRETA 2F” SH.P.K per deklarim te rreme. Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: [...], vendosi te refuzoje oferten e OE “SIRETA 2F” SH.P.K, per mospermbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese. **Si perfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, OE “SIRETA 2F” SH.P.K me Nuis K51501008J, skualifikohet.**

Ne lidhje me pretendimin e KVO-se per paraqitjen e nje deklarate te rreme sqarojme se ky pretendim eshte i pabazuar dhe ne kundershtrim me parashikimet ligjore.

Intepretim gjuhesor/literal:

Referuar fjalorit te gjuhes Shqipe kuptimi i fjales rrem/e (;), eshte: -e (e) mbiemer; 1. i genjeshtert; i shtire: lajm (alarm) i rreme; deshmi e rreme; nenshkrim i rreme; emer i rreme pseudonim; paqe (qetesi) e rreme; mik i rreme; buzeqeshje e rreme. 2. qe eshte si dicka tjeter e vertete a natyrore; artificial; i genjeshtert: mjeker e rreme; dhembe te rreme dhembe te vene; celes i rreme celes qe mund te hape shume dyer; gjelle e rreme (bised.) gjelle pa mish. 3. term ne biologji; pjese e pare e disa emertimeve te pathjeshta per bime, kafshe etj., me tipare te ngjashme me llojin e vertele: fryt i rreme; kembe te rreme (zool.) zgjatime qe u sherbejne disa kafsheve te vogla ne vend te kembeve.

[...]

Sic e kemi argumentuar edhe gjate analizimit te arsyeve te skualifikimit me larte Operatori yne ekonomik ka paraqitur deklaraten permbledhese ne perputhje me kerkesat e dokumenteve te tenderit ose duke i tejkualuar keto kerkesa. Pretendimi se "Operator; ekonomik, bazuar ne informacionin e dorezuar ne SP E me date 17. 05.2022 ka provuar me dokumentacionin vetem disponimin e 1 (nje) tekniku ndertimi sipas kerkesave te percaktuara ne dokumentet e tenderit nga 5 te deklaruar nga ana e tij. ' ' eshte i pabazuar dhe kete e kemi argumentuar edhe me larte ku kemi sqaruar se kerkesa prej 3 teknikeve te ndertimi plotesohet me pesonelin e deklaruar ne fomular dhe ne sqarimin e dhene nga ana jone ne 17.05.2022. Me larte eshte paraqitur analiza e detajuar per punonjes te deklaruar si teknik ndertimi, konkretisht: Sh.Gj, K.K, A.P, A.Gj, S.L. Nga ku rrjedh qe per sa kohe eshte plotesuar ky kriter sipas percaktimeve te dokumenteve te tenderit apo ne tejkalim te ketyre percaktimeve nuk ndodhemi ne kushtet e paraqitjes se nje deklarate te rreme. Nuk rezulton ne asnje moment qe informacioni i deklaruar te jete i rreme. Kemi paraqitur ne menyre te sakte informacionin

mbi kualifikimet e stafit te kerkuar. Ne asnje rast nuk kemi keqinformim dhe dorezim te dokumenteve, qe permbajne te dhena te rreme per qellime kualifikimi". Ne pergjigje te kerkeses suaj kemi paraqitur informacionin e sakte.

Ne si subjekt zoterojme stafin e nevojshme sipas gjitha kriterëve ligjore per te permbushur dhe tejkaluar kriteret e vendosura nga ana juaj. Sa me siper nuk ka qene e nevojshme qe te paraqesim informacion te rreme per te vertetuar mungesen e arsyeve per skualifikim ose per plotesimin e kriterëve te perzgjedhje. Ne jemi ne gjendje te dorezojme dokumentet provuese sipas kerkesave te percaktuara ne dokumentet e tenderit ne cdo kohe dhe moment qe do te kerkohet nga ana juaj. Ne lidhje me pretendimin "Ne rast te verifikimit te permbajljes se dokumentacionit te paraqitur, ose te Vetedeklarimeve, kur permbajtja e tyre nuk rezulton te jete e vertete, Operatori Ekonomik eshte ne kushtet e parashikuara ne nenin 78, pika 1, germa (a) te Ligji per Prokurimin Publik (LPP). Po ashtu edhe ne nenin 78 pika 1 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik, parashikohet se "Agjencia e Prokurimit Publik perjashton nje operator ekonomik nga e drejta per te fituar kontrata publike ku parashikohet se: Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon cdo kandidat ose ofertues, qe paraqet te dhena te rreme per qellime kualifikimi, ne cdo kohe, deri ne momentin e lidhjes se kontrates dhe raporton ne Agjencine e Prokurimit Publik, per qellimet e parashikuara ne nenin 78 te ketij ligji ", ... , sqarojme se sic u argumentua dhe vertetua me lart nuk jemi ne kushtet e paraqitjes se nje deklarate te rreme dhe ne keto kushte, pas argumentimeve nga ana jone, lutemi ne rivleresimin edhe nje here nga ana juaj te vleresimit te ofertes sone. Sic e shpjeguam edhe me larte nuk jemi para rastit te paraqitjes se deklarates se rreme dhe konkretisht rastit Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon cdo kandidat ose ofertues, qe paraqet te dhena te rreme per qellime kualifikimi, ne cdo kohe, deri ne momentin e lidhjes se kontrates dhe raporton ne Agjencine e Prokurimit Publik, per qellimet e parashikuara ne nenin 78 te ketij ligji ", AK duhet te zbatoje parimet e ligjit te prokurimit publik i cili parashikon se "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojne trajtim te barabarte dhe jo diskriminues per operatoret ekonomike, si dhe veprojne me transparence e ne menyre proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet te shmangin fushen e zbatimit te ketij ligji ose te ngushtojne ne menyre artificiale konkurrencen. Konkurrenca konsiderohet se eshte ngushtuar artificialisht kur prokurimi pergatitet me qellimin per te favorizuar ose demtuar ne menyre te padrejte operatore ekonomike te caktuar. Verejme qe ne kete procedure krijohet dyshimi i bazuar se vleresimi ofertes sone eshte i njeanshem dhe i padrejte. Nese nga ana e AK nuk do te merren ne konsiderate argumentet tone, do te vijojme paraqitjen e argumenteve tone ne organet e tjera ligjzbatuese, si KPP, APP, etj . Per sa me larte, per sa kohe asnje nga arsyet e skualifikimit te paraqitura nga KVO nuk qendron, jane te pabazuar dhe nuk jane ne perputhje me parashikimet ligjore, oferta jone duhet te kualifikohet e te vleresohet si nje oferte te vlefshme e ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit.

Se gjashti, marrim ne analize pjesen tjeter te arsyeve qe jane paraqitur ne llogarine tone ne SPE, ku eshte percaktuar: "Operatori "UDHA" ShPK me Nuis K77524909Q, nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE: Se pari nuk ploteson kriterin 2.3.1 ku parashikohet se "Operatoret ekonomike duhet te paraqese deshmi per pervojen e meparshme OE "UDHA" ShPK me Nuis K77524909Q, skualifikohet." Ne lidhje me keto percaktime gjykojme se per shkak te nje gabimi njerezor nga ana e KVO jane derguar ne llogarine tone edhe

arsyet e skualifikimit te operatorit "UDHA" ShPK me Nuis K77524909Q, per kete arsye nuk po i analizojme. Gjithsesi sqarojme se nga verifikimi arsyet e cituara KVO per operatorit "UDHA" ShPK me Nuis K77524909Q nuk qendrojne per operatorin tone ekonomik, pasi nga ana jone plotesohen te gjitha kriteret e dokumenteve te tenderit, dhe jane deklaruar dhe paraqitur ne SPE te gjithe dokumentacionin e nevojshem e te kerkuar per te faze te vleresimit. Per cdo informacion te paqarte mund te paraqisni kerkese per informacion. Se shtati, marrim ne analize oferten ekonomik te paraqitur nga ana jone. Oferta e paraqitur nga ana jone eshte ne vleren 222,222,222 leke pa TVSH dhe 266,666,666 leke me TVSH. Eshte nje oferte e cila eshte analizuar me kujdes per te garantuar realizimin me sukses te kontrates ne perputhje me te gjitha kerkesat dhe specifikimet e percaktuara ne njoftimin e kontrates dhe ne dokumentet e tenderit. Kjo per te garantuar trajnimin e punonjesve ne perputhje me parashikimet ligjore, respektimin e te gjitha rregullimeve ligjore per realizimin e punimeve, fitimin e shoqerise, si dhe respektimin e parimeve te ligjshmerise, performances, ekonomicitetit, eficenses, efikasitetit, parime keto te zbatuara edhe nga KPP, dhe KLSH gjate veprimtarise se tyre te punes. Fondi limit i kesaj procedure eshte 250,814,497.3 leke pa TVSH dhe 300,977,396.76 leke me TVSH. Nese krahasojme oferten e paraqitur nga ana jone me fondin limit te parashikuar per kete procedure rezulton se me oferten e paraqitur nga ana jone buxhetit te shtetit i kursehet nje vlere prej 28,592,275.3 leke pa TVSH dhe 34,310, 730. 76 leke me TVSH. [...]"

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1141/2 date 31.05.2022, lidhur me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimes “Sireta 2F” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 9682/4 prot, datë 01.06.2022, protokolluar me tonën me nr. 1141/3 prot datë 03.06.2022, autoriteti kontraktor ka depozituar pranë KPP shkresën me lënde “Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor Bashkia Lezhë nga OE “Sireta 2F” SHPK”, bashkëngjitur vendimi nr.1, datë 31.05.2022 i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK. Sipas këtij vendimi rezulton se KSHA e ka refuzuar ankesën e paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.5 dhe 2.3.6/d të dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesave si më poshtë vijon:

2.3.5 Krahas stafit teknik Operoret Ekonomike duhet te kene te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:

- Ing. Ndertimi	(Profili Transport)	1 (nje)	Diplome Universitare
- Ing. Ndertimi		1 (nje)	Diplome Universitare
- <u>Teknik ndertimi</u>		<u>3 (tre)</u>	<u>Diplome shkolles mesme</u>
- <u>Teknik mekanik</u>		<u>1 (nje)</u>	<u>Diplome shkolles mesme</u>
- Karpertier		1 (nje)	Deshmi Profesionale
- Shofer		10 (dhjete)	Leje Drejtimi
- Manovrator		10 (dhjete)	Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)

*Operatori ekonomik duhet te paraqes per stafin e mesiperm: Kontratat individuale te punës, Diplome Universitare/ Diplome e shkolles mesme/ Deshmitë profesionale/ Certifikate e Aftesise Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shenimeve per cdo kategori te mesiperme si dhe stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise per periudhen **Janar 2022 - Mars 2022**.*

V.O- Dokumentacioni (Diplomat/deshmite/certifikatat) qe nuk eshte leshuar sipas legjislacionit perkates te arsimimit profesional do te konsiderohen jo te sakta dhe behen shkak per veprime te metejshme sipas parashikimeve perkatese te ligjit te prokurimit publik.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

2.3.6. Operoret Ekonomike duhet te kene ne stafin teknik ose mbeshtetes, te certifikuar te pakten:

2.3.6/d -1 (nje) inxhinier Auditues/Inspektues i Sigurise Rrugore, i certifikuar sipas VKM nr. 125 date 23.02.2011 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Sigurisë Rrugore" dhe Udhezimit Nr 9 date 3.07.2012 "Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurise rrugore".

Per te permbushur kete kriter duhet te paraqitet kontrate pune, certifikaten perkatese si dhe duhet të jetë ne listepagesat e shoqerise të paktën për periudhën Janar 2022 - Mars 2022.

Shenim: Kjo kerkese permbushet nepermjet paraqitjes nga operoret ekonomik te formularit

permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces perkatese te DST-se dhe dokumentacioni i kerkuar duhet te paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar, i pari perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe fillimit te afateve te ankimimit.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar të plotësuar shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, ku në pjesën III “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, gërma “B” Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate” është deklaruar si vijon:

“[...] Shoqeria disponon më shumë se 60 punonjes sipas përcakimeve të D.S.T- (mesatarisht gjatë 3 muajve të fundit janë 90 punonjës). Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtë shënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

1. Z. B.Sh, me profesion inxhinier ndertimi, ne licence, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin DREJTUES TEKNIK Inxhier ndertimi.

2. Z. A.C, me profesion inxhinier mjedisi, ne licence, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin DREJTUES TEKNIK Inxhinier mjedisi.

3. D.F, me profesion ixh.Gjeodet, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Drejtuese Teknike inxhiniere gjeodet.

4. E.T, me profesion Inxhinier Ndertimi, e punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin Inxhiniere ndertimi..

5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh, A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndertimit;

6. Teknik Mekanik: K.D, me profesion inxhiniere Mekanike, Xh.H dhe I.M me profesion mekanik të punësuar pranë shoqërisë sonë;

7. Karpentier: Z.P dhe S.H me profesion karpentier të punësuar pranë shoqërisë sonë;

8. Shofer: D.D, E.D, A.M, I.L, M.Ç, J.H; Z.S

9. Manovrator: T.L, E.L, M.N, B.M, A.I dhe A.M,

10. Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë: B.Sh, me profesion inxhinier Ndertimi, Drejtues Teknik i punimeve, ne licence.

11. Ekspert per Ndihmen e Pare dhe Nderhyrjen ndaj Emergjencave: E.M (Ruçi) dhe M.M;

12. Auditues/Inspektues i sigurise rrugore: F.H, me kontrate bashkepunimi noteriale nr. Rep 5254 dhe nr.kol 2572, dhe K.D.”

III.1.4. Gjithashtu, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, krahas ankesës me nr. 1141/2022 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2231, është administruar edhe dokumentacioni i operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK, lidhur me stafin teknik, objekt-ankimimi.

III.1.5. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë

paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.7. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “ç” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose.[...]”

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

III.1.9. Lidhur me pretendimet e autoritetit kontraktor se “ (OE “Sireta 2F” SHPK) nuk ka plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas formatit të miratuar në DST.KVO konsaton se Operatori Ekonomik nuk i është përmbajtur formatit të miratuar në DST-ne e procedurës së prokurimit me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhe”, në plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në seksionin “B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, në të cilën përcaktohet formati i deklaratës, konkretisht si më poshtë vijon: “Gjithashtu, disponoj personelit kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse: Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____, ”. KVO verën se në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit OE “SIRETA 2F” SH.P.K, ka shmangur qëllimisht frazën “Z. _____ me profesion” dhe ka deklaruar se: “5. Teknik ndertimi: Sh.Gj, S.L dhe K.K, A.Xh , A.P, të punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e teknikëve të ndërtimit”, nga shqyrtimi i formularit të vetëdeklarimit të dorëzuar në SPE nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK rezulton, se deklarata për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate, është plotësuar dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit. Në këtë deklaratë nga ana e ankimuesit jepet informacion, përveç të tjerave, për teknikët e ndërtimit, duke deklaruar 5 (pese) të tillë dhe për secilin është deklaruar emri, mbiemri, si dhe është pohuar se janë të punësuar pranë shoqërisë "Sireta 2" SHPK në rolin e teknikëve të ndërtimit. I njëjti informacion është dhënë edhe për tekniket mekanikë, karpentierët, shoferët etj. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se informacioni që përmban deklarata për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate, është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara në formularin e vetëdeklarimit sipas dokumenteve standarde të tenderit. Fakti i konstatuar nga autoritetit kontraktor se ankimuesi nuk i është përmbajtur formatit të miratuar në DST, nuk qëndron, pasi deklarimi i shoqërisë “Sireta 2F” SHPK i përmban të gjitha elementet e parashikuara në dokumentet e tenderit lidhur me emrin, mbiemrin, profesionin dhe “të punësuar në shoqëri në rolin e ...”.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.1.10. Lidhur me arsyen e skualifikimit se “Operatori Ekonomik me shkresen e dates 17.05.2022, ne SPE me lende “Dhenie informacioni”, paraqiti argumentet e tij ku rezulton se disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi (Sh.Gj), nga 3 (tre) te kerkuar ne DST, si dhe 1 nje teknik mekanik (Xh.H). Ndersa pjesa tjeter e stafit, te deklaruar ne Formularin Përmbledhës te Vetëdeklarimit, bazuar ne informacionin e paraqitur nga OE “SIRETA 2F”, nuk rezulton me profesion Teknik Ndertimi apo teknik mekanik me Diplome te Shkolles se Mesme siç eshte deklaruar ne kete formular, por si me poshte vijon: S.L - Kurs trajnimi per Teknik ndertimi (certifikate trajnimi AQSCERT), Dëshmi kualifikimi sigurimi Teknik – Trup certifikues TCPE; K.K - Kurs Qendror Te pergatitjes dhe Kualifikimit te Kuadrove Bujqesore ne Tirane Teknik. A.Xh - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. A.P - Universiteti Politeknik i Tiranës – Fakulteti i Inxhinierise se Ndertimit – Diplome Bachelor ne Inxhinieri Ndertimi. [...]Sa me siper duke qene se OE disponon vetem 1 (nje) teknik ndertimi ne perputhje me kriterin 2.3.5 te DST-se nga 3 (tre) teknik ndertimi te kerkuar ne DST, ky kriter konsiderohet i papermbushur.”, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se për përmbushjen e kriterit 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve standarde të tenderit për disponimin e 3 (tre) teknikëve të ndërtimit, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit (shtojca 8). Në këtë formular shoqëria “Sireta 2F” SHPK ka deklaruar 5 teknikë ndërtimi, nga të cilët, autoriteti kontraktor gjykon, se vetëm punonjësi Sh.Gj plotëson kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit për teknik ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, si më sipër cituar, rezulton, se është kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë për stafin e mësipërm: Kontratat individuale të punës, Diplomë Universitare/ Diplomë e shkollës së mesme/ Dëshmitë profesionale/ Certifikatë e Aftësisë Profesionale (CAP)/ Leje Drejtimi sipas shënimeve për çdo kategori të mësipërme, si dhe stafi i mësipërm të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën janar 2022 - mars 2022. Për plotësimin e kërkesave të autoritetit kontraktor për 3 teknikë ndërtimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK, përveç të tjerave, rezulton se për punonjësin A.Xh, deklaruar “teknik ndërtimi” është paraqitur Kontrata e punës e lidhur në datën 10.09.2020 me punëmarrës A.Xh dhe punëdhënës “Sireta 2F” SHPK. Gjithashtu është paraqitur Diploma Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës në datën 07.05.2019, Dëshmia e kualifikimit të sigurimit teknik për profesionin “teknik ndërtimi”, librezë pune dhe CV për A.Xh. Nga verifikimi i listëpagesave rezulton, se A.Xh është i punësuar pranë shoqërisë “Sireta 2F” SHPK për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor janar-mars 2022. Rezulton, se është paraqitur Kontrata e punës e lidhur në datën 25.05.2021 me punëmarrës A.P dhe punëdhënës “Sireta 2F” SHPK. Gjithashtu, është paraqitur Diploma Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi, lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës në datën 07.05.2019, Diploma Master i Shkencave në Ndërtim, profili Gjeoteknikë, librezë pune dhe CV për A.P. Nga verifikimi i listëpagesave rezulton se A.P është i punësuar pranë shoqërisë “Sireta 2F” SHPK për periudhën e kërkuar nga autoriteti kontraktor janar-mars 2022. Sqarojmë, se kualifikimet e personelit inxhinier i tejkalojnë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke i përmbushur dhe tejkualuar nevojat e këtij të fundit.

Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK provon, se i ka të punësuar tre punonjës teknikë ndërtimi, në përputhje dhe në tejkallim të kërkesave të autoritetit kontraktor si më sipër cituar. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për tre teknikë ndërtimi.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.1.11. Lidhur me pretendimet e autoritetit kontraktor për inxhinierin Auditues/Inspektues i Sigurisë Rrugore, rezulton, se në shtojcën 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të plotësuar nga ankimuesi, në pjesën III “*Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit*”, gërma “B” Deklaratë “*Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt-kontrate*” operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK ka deklaruar: “*Auditues/Inspektues i sigurisë rrugore: F.H, me kontrate bashkëpunimi noteriale nr. Rep 5254 dhe nr.kol 2572, dhe K.D.*” Pra, në përmbushje të kriterit për *Auditues/Inspektues i sigurisë rrugore*, ankimuesi ka deklaruar se disponon marrëveshje bashkëpunimi me z. F.H, përveç Znj.K.D. Në mbështetje të deklaratës së tij për z. F.H, në Sistemin e Ankesave Elektronike shoqëria “Sireta 2F” SHPK ka paraqitur Akt-Marrëveshje (kontratë bashkëpunimi) me z. F. H, me nr. Rep 5254 dhe nr.kol 2572 date 11.05.2022, për procedurën e prokurimit objekt-ankimimi. Kjo aktmarrëveshje është shoqëruar me Diplomë nga Universiteti i Tiranës, në emër të F.H, për titullin “*Inxhinier Mekanik*”, Certifikatë Aftësie për Auditues/Inspektues të Sigurisë Rrugore (ASR/ISR), lëshuar nga Instituti i Transportit në Korrik 2017 si dhe librezë e punës e F.H.

III.1.11.1. Në nenin 84 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”

III.1.11.2. Gjithashtu edhe në nenin 90 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, thuhet se:

1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;
- t’i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.
- t’i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.
- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.

III.1.11.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit, rezulton se në Njoftimin e kontratës, në pikën 2.16 të saj, është parashikuar si vijon:

“2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

Jo

X

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:”

Pra rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është lejuar mbështetja e operatorëve ekonomikë në kapacitetet e subjekteve të tjera, gjë e cila ligjëron mbështetjen e siguruar të operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK nga z.F.H, në përputhje me nenin 84 të LPP-së si rregullave të prokurimit publik, si më sipër cituar.

Për sa më sipër cituar, duke qenë se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet, që operatori ekonomik zotëron personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës objekt-shqyrtimi, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK provon se disponon një Auditues/Inspektues i sigurisë rrugore, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor si më sipër cituar, si dhe në përputhje me nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 92/3 të LPP-së ku përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.1.12. Për sa i përket pretendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me informacionin e rremë të paraqitur nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK, në informacionin dhe dokumentacionin e administruar në Komisionin e Prokurimit Publik, nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë njoftuar Agjencinë e Prokurimit Publik për konstatimin e tij, në kundërshtim me 78, pika 1, gërma “a” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” sipas të cilit: “1. Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: a) keqinformim dhe dorëzim të dokumenteve, që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi; [...]”

III.1.13. Së fundi, lidhur me pretendimet e autoritetit kontraktor për punonjësit “Teknik mekanik” të deklaruar nga shoqëria “Sireta 2F” SHPK, rezulton, se vetë autoriteti kontraktor në informacionin e tij, pranon se njëri nga punonjësit e deklaruar plotëson kërkesat e tij për teknik mekanik. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e shoqërisë “Sireta 2F” SHPK përmbushet kërkesa e AK-së për një punonjës “teknik mekanik”, duke mos përbërë objekt-shqyrtimi në KPP.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2018, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-26273-04-25-2022, me objekt: “Sistemi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”, me fond limit 250,814,497.3 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 11.05.2022 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lezhë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Sireta 2F” SHPK , duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sireta 2F” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

